



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1057/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Milena Đerić kryesuese, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Podujevës Burim Januzi nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Podujevës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet i palejuar apeli Anr.1057/2021, i datës 04.11.2021, parashtruar nga Burim Januzi nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Podujevës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin ka kërkuar rinumërim të votave në Vendvotimet VV 1811E/01D, VV 1824E/04R, VV 1831E/02D, VV 1836E, VV 1816E/01R, VV 1810E/02D dhe VV 1830E/02D.

A r s y e t i m

Me datë 04.11.2021, PZAP-i ka pranuar apelin Anr.1057/2021 të parashtruar nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Podujevës Burim Januzi nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, në të cilën pretendon se në Vendvotimet VV 1811E/01D dyshon se i kanë humbur së paku pesë vota, VV 1824E/04R e kanë votuar familjar të tij mirëpo nuk i figurojnë votat, VV 1831E/02D ka pasur keqpërdorime dhe është dëmtuar për një votë, VV 1836E/01 është dëmtuar për tri vota, VV 1816E/01R thekson se kanë votuar disa persona mirëpo votat nuk i kanë dalë, VV 1810E/02D nuk i kanë dalë votat dhe i janë

tjetërsuar dhe VV 1830E/02D po ashtu nuk i figurojnë tri vota. Si dëshmi ka paraqitur FRK në, FLLCK si dhe deklaratat e katër dëshmitarëve.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i palejuar

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se apeli i parashtruar nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Podujevës Burim Januzi nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, dega në Komunën e Podujevës, ka njëjtësi subjektive, objektive, gjendje të njëjtë faktike me apelin e parashtruar për të cilin është vendosur me vendimin e PZAP-it Anr.848/2021 të datës 05.11.2021.

Nga kjo gjendje e vërtetuar faktike rezulton fakti se pretendimi nga apeli i parashtruar nga Burim Januzi nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, dega në Komunën e Podujevës është konsumuar me vendimin e cekur më lartë A.nr.848/2021.

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr.848/2021 të datës 05.11.2021, dhe pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të kësaj çështje të theksuar në ankesë.

Paneli, duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it 02/2015, si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.1057/2021 më datën 07.11.2021

Kryesuesja e Panelit
Milena Deri

Milena Deri



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.